



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.54**

**12 maj**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9712 datë 16.4.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar.....	1419
Ligj nr.9714 datë 16.4.2007	Për një ndryshim në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar.....	1421
Ligj nr.9715 datë 16.4.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9461, datë 21.12.2005 “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”.....	1422
Ligj nr.9716 datë 16.4.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.....	1424
Ligj nr.9718 datë 19.4.2007	Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë.....	1426

**LIGJ**  
**Nr.9712, datë 16.4.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR  
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 3 e nenit 20 “Toka dhe ndërtesat” ndryshohet si më poshtë:

“3. Dhënia me qira e ndërtesave është furnizim i përjashtuar, përveç rasteve:

- a) të dhënies me qira për një periudhë jo më shumë se dy muaj;
- b) të strehimit në hotele ose vende pushimi.”.

Neni 2

Neni 22 “Banka e Shqipërisë” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22  
**Bankat**

Furnizimi i arit nga Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë, si dhe i bankënotave dhe i monedhave nga Banka e Shqipërisë është furnizim i përjashtuar.”.

Neni 3

Pas pikës 4 të nenit 26 “Importimi i mallrave” shtohen pikat 5 e 6 me këtë përmbajtje:

“5. Vlera e tatueshme për arin e përpunuar, të importuar, përcaktohet sipas pikave 3 e 4 më lart, pa përfshirë vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë. Mënyra e llogaritjes së vlerës së arit të përdorur si lëndë e parë përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

6. Operatorët e telefonisë celulare do të vazhdojnë të ofrojnë shërbimet e tyre për të gjitha kartat SIM dhe numrat IMEI të aparateve celulare, që janë në përdorim në datën 1 tetor 2007. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, duke filluar nga data 1 tetor 2007, operatorët e telefonisë celulare do të ofrojnë shërbimet e tyre vetëm për numrat IMEI të aparateve celulare, për të cilat importuesit apo zotëruesit e tyre kanë ndjekur procedurën e mëposhtme:

a) importuesit e aparateve telefonike celulare, në çastin e deklarimit dhe të pagesës së detyrimeve fiskale pranë shërbimit doganor, duhet të deklarojnë edhe listën e numrave IMEI të aparateve të importuara;

b) individët, të cilët, në çastin e hyrjes në doganë, zotërojnë aparate celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është mbi minimumin e patatueshëm, të vendosur me ligj, ndjekin të njëjtën procedurë si në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) individët, të cilët, në çastin e hyrjes në doganë, zotërojnë aparate celulare, që futen për herë të parë në Shqipëri, vlera e të cilave është nën minimumin e patatueshëm, të vendosur me ligj, duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë pranë shërbimit doganor një deklaratë individuale për numrin IMEI të aparatit telefonik celular.

Shërbimi doganor njofton zyrtarisht operatorët e telefonisë celulare për numrat IMEI, të deklaruar nga importuesit dhe individët, në përputhje me shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike. Forma e deklaramit të numrave IMEI nga importuesit dhe individët përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

#### Neni 4

Pas nenit 27/1 shtohet neni 27/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/2

#### **Furnizimi i arit të përpunuar**

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar, të furnizuar brenda vendit, nuk përfshin vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë. Mënyra e llogaritjes së vlerës së arit, të përdorur si lëndë e parë, përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

#### Neni 5

Pika 8 e nenit 36 “Faturat” shfuqizohet.

#### Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5287, datë 8.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**LIGJ**  
**Nr.9714, datë 16.4.2007**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002 “PËR AKCIZAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

**Neni 1**

Në shtojcën 1/1 kreu V, që i bashkëlidhet ligjit, bëhet ndryshimi sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5289, datë 8.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

Shtojca 1/1

**MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla tatimore
V	NËNPRODUKTET E NAFTËS	
91 10	34 03 19 34 03 99 Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg

**LIGJ**  
**Nr.9715, datë 16.4.2007**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9461, DATË 21.12.2005 “PËR  
NOMENKLATURËN E MALLRAVE DHE TARIFËN DOGANORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9461, datë 21.12.2005 “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”, bëhen këto shtesa e ndryshime:

**Neni 1**

Në titull, pas fjalës “tarifën” shtohet fjala “e integruar”.

**Neni 2**

Në nenin 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

- a) Në pikën 1 fjalët “Këshilli i Ministrave miraton një nomenklaturë mallrash” zëvendësohen me fjalët “Këshilli i Ministrave miraton publikimin zyrtar të nomenklaturës”.
- b) Në paragrafin e parë të pikës 3 fjalët “të nxjerrë vendimin përkatës për përditësimin e” zëvendësohen me fjalët “të miratojë botimin e përditësimit të”.
- c) Në paragrafin e dytë të pikës 3 fjalët “Vendimi i Këshillit të Ministrave” zëvendësohen me fjalët “Botimi i miratuar nga Këshilli i Ministrave”.

**Neni 3**

Në nenin 2 fjalët “Këshilli i Ministrave miraton” zëvendësohen me fjalët “Këshilli i Ministrave publikon”.

**Neni 4**

Në pikën 1 të nenit 5 fjalët “për të cilin bën fjalë neni 28 i Kodit Doganor” zëvendësohen me fjalët “sipas përcaktimit të dhënë në nenin 28 të Kodit Doganor”.

**Neni 5**

Në nenin 7 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

- a) Në fjalinë e parë të paragrafit të parë, fjala “miratohet” zëvendësohet me fjalët “publikohet një herë në vit”.
- b) Në fjalinë e tretë të paragrafit të parë fjalët “përditësohet” dhe “çdo vit” shfuqizohen.
- c) Në paragrafin e dytë, fjalët “dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, ndërmerr, ndër të tjera, dhe këto hapa:” zëvendësohen me fjalët “bashkërendon punën për:”.
- ç) Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:  
“Drejtoria e Përgjithshme e Doganave shërben si sekretari teknike e Komitetit të Nomenklaturës së Mallrave.”.

Neni 6

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Komiteti i Nomenklaturës së Mallrave kryesohet nga Ministri i Financave dhe ka në përbërje:

- Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
  - Ministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
  - Drejtorin e Përgjithshëm të INSTAT-it;
  - Kryetarin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë.
- Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e funksionimit të këtij komiteti.”.

Neni 7

Në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në shkronjën “a” të pikës 1 fjala “zbatimin” zëvendësohet me fjalën “hartimin”.
- b) Paragrafi i parë i pikës 2 ndryshohet si më poshtë:  
“Hartimi i nomenklaturës bëhet në përputhje me:”.

Neni 8

Paragrafi i dytë i nenit 11 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 12 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në paragrafin e parë, pas fjalëve “Këshilli i Ministrave” shtohen fjalët “brenda janarit”.
- b) Paragrafi i dytë dhe i tretë shfuqizohen.
- c) Pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:  
“Drejtoria e Përgjithshme e Doganave zhvillon procedurat për riprodhimin e versionit të plotë të Nomenklaturës së Mallrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.  
Fondet për riprodhimin dhe procedurat e përcaktuara në paragrafin e dytë të këtij neni mbulohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5290, datë 8.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**LIGJ**  
**Nr.9716, datë 16.4.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Shkronja “h” e nenit 4 ndryshohet si më poshtë:

“h) të ardhurat e realizuara nga shërbimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një person jorezident.”.

**Neni 2**

Neni 11 "Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme" riformulohet si më poshtë:

“Neni 11

**Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme**

1. Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, tokë e ndërtesa, tatohet me 10 për qind të fitimeve kapitale të realizuara. Ky paragraf nuk zbatohet në rastet e shkëmbimit të së drejtës së pronësisë mbi tokën me të drejtën e pronësisë mbi ndërtesën e ndërtuar mbi tokë. Në këtë rast tatimi i të ardhurave kryhet sipas procedurës së dhënë në paragrafin e dytë të nenit 2 të këtij ligji.

2. Tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

3. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që, brenda 10 ditëve, të transferojnë për llogari të administratës tatimore tatimin e paguar, sipas parashikimeve të këtij neni.”.

**Neni 3**

Shkronja “d” e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

“d) për rastet e shkeljeve të dispozitave të parashikuara në shkronjën “e” të nenit 14, punëdhënësi gjobitet me 10 për qind të shumës së tatimit të mbajtur në burim, të deklaruar me vonesë, por jo më pak se 10 mijë lekë.”.

#### Neni 4

Në fund të nenit 20 "Shpenzime të njohura", shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Për veprimtaritë e ndërtimit dhe shitjes së ndërtesave me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, njihet si shpenzim i zbritshëm edhe vlera e truallit të vënë në dispozicion nga pronari i tokës, sipas kontratave të këmbimit të truallit me sipërfaqe ndërtimi. Metodika e përcaktimit të vlerës së truallit për m<sup>2</sup> miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe bazohet në koston minimale fiskale të ndërtimit, sipas qyteteve apo zonave brenda qyteteve.

Për veprimtaritë e ndërtimit dhe shitjes së ndërtesave me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, në të ardhurat e tatueshme të investitorit llogariten edhe të ardhurat që i korrespondojnë pjesës së sipërfaqes së ndërtimit që përfitojnë pronarët e truallit për rastet e kontratave të këmbimit truall-sipërfaqe ndërtimi. Vlerësimi i të ardhurave për pjesën e pronarit të truallit bëhet në të njëjtën mënyrë si për pjesën e të ardhurave të realizuara nga investitori dhe ai bazohet në metodikën e miratuar nga Këshilli i Ministrave lidhur me fitimin minimal fiskal.

Për ndërtimet e ulëta vetjake, për të cilat jepet leje ndërtimi nga komunat e bashkitë dhe që ndërtohen me individë të paregjistruar pranë organeve të administratës tatimore, zbatohen të njëjtat dispozita që rregullojnë pagimin e kontributit të sigurimeve shoqërore edhe në shoqëritë ndërtuese të regjistruara. Komunat e bashkitë që japin lejen, ngarkohen të vjelin e të transferojnë kontributet, sipas përcaktimeve të dhëna në udhëzimin e Ministrisë të Financave.”.

#### Neni 5

Kreu III/a “Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin” dhe nenet 32/1, 32/2, 32/3, 32/4, 32/5, 32/6, 32/7 dhe 32/8 të këtij kreu shfuqizohen.

#### Neni 6

##### **Dispozita kalimtare**

Neni 2, që ndryshon nenin 11 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 dhe neni 4, që ndryshon nenin 20 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, fillojnë të zbatohen më 1 janar 2008.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi më 1 korrik 2007.

**Shpallur me dekretin nr.5291, datë 8.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**LIGJ**  
**Nr.9718, datë 19.4.2007**

**PËR URDHRIN E INFERMIERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Qëllimi i ligjit**

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet juridike të profesioneve infermier, mami, fizioterapeft, si dhe organizimin e Urdhrit të Infermierit.

Neni 2  
**Fusha e zbatimit**

Ky ligj e shtrin veprimtarinë e vet në të gjithë territorin e vendit dhe zbatohet për të gjithë infermierët, mamitë dhe fizioterapeftët që ushtrojnë këtë profesion në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3  
**Statusi**

Urdhri i Infermierit është ent publik jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesioneve të infermierit, të mamisë dhe fizioterapeftit, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut.

KREU II  
MISIONI DHE BUXHETI

Neni 4  
**Kriteret e anëtarësisë**

1. Urdhri i Infermierit përbëhet nga infermierët dhe mamitë që kanë diplomën përkatëse dhe që e ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë.

2. Shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të diplomuar si infermierë ose mami në Republikën e Shqipërisë, bëhen menjëherë anëtarë të Urdhrit, me pagimin e kuotizacionit dhe regjistrimin pranë tij.

3. Anëtarë të Urdhrit të Infermierit bëhen edhe të gjithë infermierët dhe mamitë, shtetas shqiptarë dhe të huaj, të diplomuar jashtë vendit, pas njohjes së diplomës, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Shtetasi i huaj, që të ushtrojë profesionin e infermierit dhe mamisë në Republikën e Shqipërisë, duhet të jetë anëtar relativ i të njëjtit urdhër në vendin e vet ose në vendin ku së fundi ka ushtruar këtë profesion.

5. Përrjashtohen nga ky detyrim, por jo nga e drejta e anëtarësimit në këtë organizëm, nëpunësit e administratës shtetërore, për sa kohë ata nuk ushtrojnë veprimtari të mirëfilltë si mami, infermier ose fizioterapeft.

#### Neni 5

### **Detyrimi për anëtarësi**

1. Asnjë individ nuk mund ta ushtrojë profesionin e infermierit, të mami së apo fizioterapeftit në Republikën e Shqipërisë pa qenë anëtar i Urdhrit të Infermierit.

2. Punëdhënësit e institucioneve shëndetësore, publike dhe private, të shërbimit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor, ndalohen t'i punësojnë ata në kundërshtim me këtë dispozitë.

#### Neni 6

### **Misioni i Urdhrit të Infermierit**

1. Urdhri i Infermierit ka si mision ruajtjen e standardeve të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë, në ushtrimin e profesionit infermier, mami ose fizioterapeft, nëpërmjet mbikëqyrjes së normave të etikës dhe të Kodit Deontologjik të profesioneve infermier, mami dhe fizioterapeft, si dhe mbrojtjes së pacientëve dhe të publikut nga kequshtrimi i profesionit të infermierit, mami së apo fizioterapeftit.

2. Në përmbushje të këtij misioni, Urdhri i Infermierit:

a) kryen regjistrimin e infermierëve, mami ve dhe fizioterapeftëve në regjistrin përkatës të këtij urdhri;

b) mbikëqyr zbatimin e detyrave profesionale, në përputhje me kërkesat e shkencave mjekësore, rregullat e etikës dhe Kodin Deontologjik;

c) siguron udhëheqjen etiko-morale e deontologjike të bashkësisë së infermierëve, mami ve dhe fizioterapeftëve, pavarësinë e ushtrimit të profesionit dhe mbron interesat moralë të këtij profesioni;

ç) mbron interesat e pacientëve dhe të publikut nga kequshtrimi i mjekësisë dhe shkelja e Kodit Deontologjik Mjekësor nga ana e infermierëve, mami ve dhe fizioterapeftëve;

d) bashkëpunon për zhvillimin e standardeve profesionale, për planifikimin dhe hartimin e programeve të formimit profesional për realizimin e specializimeve të ndryshme dhe të edukimit në vazhdim të mami ve, infermierëve dhe fizioterapeftëve;

dh) konfirmon anëtarësinë në Urdhrit të Infermierit, nëpërmjet dhënies së certifikatës së anëtarësimit.

#### Neni 7

### **Bashkëpunimi**

Urdhri i Infermierit, për ushtrimin e misionit, mban lidhje dhe bashkëpunon me Ministrinë e Shëndetësisë, me institucionet vartëse të saj, si dhe me institucione të tjera publike dhe private.

#### Neni 8

### **Buxheti**

1. Urdhri i Infermierit ka buxhetin e vet, të cilin e vetadministron në përputhje me rregullat financiare në fuqi.

Burimet financiare të Urdhrit të Infermierit janë:

a) kuotizacionet e anëtarëve, të miratuara nga Këshilli Kombëtar këtij Urdhri;

b) tarifat e regjistrimit;

c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

2. Të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Urdhri i Infermierit i përdor për të përmbushur misionin e caktuar me këtë ligj.

3. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit miraton buxhetin vjetor, si dhe pagat e shpërblimet.

### KREU III ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

#### Neni 9

#### **Organet kryesore**

Organet kryesore të Urdhrit të Infermierit janë:

- a) asambletë;
- b) këshillat;
- c) komisionet disiplinore.

#### Neni 10

#### **Asambletë**

1. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga tërësia e anëtarëve të këshillave rajonalë.
2. Asambleja e Përgjithshme zgjedh Këshillin Kombëtar. Zgjedhjet për anëtarë të Këshillit Kombëtar bëhen çdo 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Asambleja rajonale përbëhet nga tërësia e përfaqësuesve të anëtarëve të Urdhrit të Infermierit të qarkut.
4. Zgjedhjet në këshillin rajonal bëhen çdo 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

#### Neni 11

#### **Këshilli rajonal**

1. Këshilli rajonal krijohet sipas ndarjes administrative-territoriale në bazë qarku dhe zgjidhet nga asambleja rajonale.  
Këshilli rajonal zgjedh presidentin dhe zëvendësit e tij.  
Këshilli rajonal emëron dhe shkarkon sekretarin e tij.
2. Mandati i presidentit është 5 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje.

#### Neni 12

#### **Këshilli Kombëtar**

1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit përbëhet nga 17 anëtarë si më poshtë:
  - a) Presidenti i Urdhrit të Infermierit;
  - b) presidentët e këshillave rajonalë;
  - c) një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë;
  - ç) një përfaqësues i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
  - d) një përfaqësues i Shkollave të Larta të Infermierisë;
  - dh) një përfaqësues i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
2. Rastet e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar parashikohen në statutin, të cilin e miraton Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit.
3. Këshilli Kombëtar zgjedh presidentin dhe zëvendësit e tij. Mandati i presidentit është 5-vjeçar me të drejtën e një rizgjedhjeje. Funkzioni i tij është i papajtueshëm me funksione të tjera drejtuese në administratën shtetërore.

4. Këshilli Kombëtar emëron dhe shkarkon sekretarin e përgjithshëm.
5. Vendimet e Këshillit Kombëtar merren me shumicë votash, kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Neni 13  
**Komisionet disiplinore**

1. Pranë Këshillit Kombëtar dhe këshillave rajonalë të Urdhrit të Infermierit funksionojnë komisionet disiplinore, të cilat caktohen nga këshillat përkatës.
2. Komisionet disiplinore janë organizma të gjykimit profesional. Ato verifikojnë dhe shqyrtojnë ankesat për shkeljet e etikës mjekësore, të Kodit Deontologjik, si dhe gabimet mjekësore nga anëtarët e Urdhrit të Infermierit.
3. Komisionet disiplinore pranë këshillave rajonalë ushtrojnë përgjegjësi disiplinore të shkallës së parë. Vendimet e tyre ankimohen në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar, i cili ushtron kompetenca disiplinore të shkallës së dytë.

Neni 14  
**Kodi Deontologjik**

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit miraton Kodin Deontologjik të profesioneve infermier, mami dhe fizioterapeft.

Neni 15  
**Statuti**

Veprimtaria e Urdhrit të Infermierit rregullohet me statut, i cili miratohet nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Infermierit.

Neni 16  
**Masat disiplinore**

1. Komisioni disiplinor mund të vihet në lëvizje nga një ankesë e paraqitur me shkrim apo me gojë, por ai mund të vihet në lëvizje edhe kryesisht.
2. Komisioni disiplinor heton dhe gjykon, në bazë të fakteve dhe provave të administruara, në seancë dëgjimore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës mjekësore, të Kodit Deontologjik ose ka bërë gabim mjekësor, ai jep masat e mëposhtme:
  - a) vërejtje me shkrim;
  - b) vërejtje me paralajmërim;
  - c) gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;
  - ç) propozim për shkarkim nga funksionet drejtuese në institucione shëndetësore;
  - d) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Infermierit deri në 3 vjet;
  - dh) përjashtim i përkohshëm nga Urdhri i Infermierit për një periudhë deri në 3 vjet.
3. Përveç masave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, si masë plotësuese, komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese.
4. Masat e mësipërme disiplinore mund të shlyhen, nëse ndaj anëtarit, brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni dhe brenda 3 vjetëve nga data e dhënies, për shkronjat "ç", "d" dhe "dh", nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

Neni 17  
**Ankimi**

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga komisionet disiplinore,

pranë këshillave rajonale të Urdhrit të Infermierit paraqiten në komisionin disiplinor të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Infermierit brenda 30 ditëve nga komunikimi me shkrim i vendimit.

2. Komisioni disiplinor i Këshillit Kombëtar, brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar është përfundimtar.

3. Kundër vendimit të komisionit disiplinor të Këshillit Kombëtar, personi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës brenda 30 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

Neni 18

#### **Financimi**

Urdhri i Infermierit financohet nga shteti për një periudhë dyvjeçare. Masa dhe mënyra e këtij financimi përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.

#### **KREU IV**

#### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 19

#### **Organizimi i zgjedhjeve**

1. Ministri i Shëndetësisë ngarkohet të ngrëjë një komision të përkohshëm, i cili, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, organizon zgjedhjet e para të këshillave rajonale dhe të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Infermierit.

2. Me zgjedhjen e Këshillit Kombëtar, komisioni i përkohshëm shkrihet.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5293, datë 8.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468**  
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
  - 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500**
  - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) ..... 600**
  - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
  - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

### **Botime të reja**

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 10.5.2007  
 Doli nga shtypi më 12.5.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “Grafon”  
 Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë